

Çka do të thotë sot në botën e globalizuar socialdemokracia?  
Ç'është demokracia sociale?

A është i mjaftueshëm interesimi i qytetarëve për politikë?  
A mund të ngjallet serish interesimi i tillë?

A janë kompatible dinamika ekonomike dhe drejtësia sociale?  
Cilat politika konkrete janë treguar të aplikueshme?

Sa kanë qenë ato të suksesshme?

Këto dhe pyetjet e tjera janë të rëndësishme në të gjitha rajonet e botës. Përmes editimit të publikimit "**Forumi demokracia sociale – vizionet dhe opsionet për Evropën Juglindore**" Fondacioni Fridrih Ebert (Friedrich-Ebert-Stiftung) dëshiron të jap kontributin e vet në debatin që zhvillohet në Evropën Juglindore në këtë temë. Publikimet do të përcillen nga forumi në internet ([www.forum-social-democracy.org](http://www.forum-social-democracy.org)). I ftojme të gjithë lexuesit të marrin pjesë aktive në këto debate.

**Fondacioni Fridrih Ebert**  
**Zyra në Beograd**  
Simina 1  
11000 Beograd  
**Serbi dhe Mali i Zi**

**Fondacioni Fridrih Ebert**  
**Zyra në Sarajevë**  
Sumbula Avde 7  
71000 Sarajevë  
**Bosnjë dhe Hercegovinë**

**Fondacioni Fridrih Ebert**  
**Zyra në Zagreb**  
Prashka 8  
10000 Zagreb  
**Kroaci**

- Teksti del edhe në gjuhën maqedone, shqipe, bullgare dhe rumune.
- Të gjitha tekstet mund të gjenden në internet, në [www.fes.org.yu](http://www.fes.org.yu)

- UE mbetet një ndërthurje e vendeve dhe interesave
- Preferencat partiake të konservativëve dhe të libelarëve, në fushat qendrore politike, janë relativisht të ngjashme
- Partitë socialdemokrate marrin tendencialisht pozicion më të afërt me integrimet
- Dallimet në mes partive të majta sa i përket politikave dhe strukturave specifike janë posaqërisht të mëdha kur bëhet fjalë për çështjet e politikave të shpërndarjes.

Marius Busemeyer, Christian Kellermann,  
Alexander Petring, Andrej Stuchlik\*

## Pozicionet Politike mbi Modelin Ekonomik dhe Social European – Një tregues i interesave

### Sondazhi

Hulumtimi në vijim përqëndrohet në pozicionet e partive, sindikatave dhe organizatave të punëdhënësëve mbi modelin ekonomik dhe social european. Një anketë me pyetjet rreth: politikës ekonomike, sociale dhe konkurrencës (garat në mes të shteteve anëtare) është bërë me mbi 100 personalitete udhëheqëse nga partitë, sindikatat, ministritë, parlamentet dhe shoqatat e punëdhënësëve në gjithësejt 17 vende.<sup>1</sup>

Dy çështje qendrore ishin në qendër të vëmendjes:

- 1) Në cilat fusha mund të gjenden përuethshmëritë/divergjencat në pozicionet e partive dhe organizatave?
- 2) Si mund të shpjegohen gjërat e përbashkëta dhe ndryshimet?

<sup>1</sup> Ky studim ndërtohet mbi një projekt hulumtues të Fridrich-Ebert-Stiftung. Pyetësi, vlerësimi mbi vëndet dhe fondi i të dhënave mund të mirren nga internet-faqja e Friedrich-Ebert-Stiftung: <http://www.fes.de/internationalepolitik>. Rreth zhvillimit të pyetjeve dhe diskutimit ekonomik për modelin ekonomik dhe social european, shih Petring/Kellermann 2005.

## Mbetet e diskutueshme nëse ekziston „një“ model ekonomik dhe social european

Është për tu diskutuar se sa mund të flitet për një model ekonomik dhe social european. Përkrahësit e theksojnë një konsens socialo-politik të gjithëmbarshtëm shoqëror, i cili sunduaka në të gjitha vendet europiane. Në variantat e shumta të modeleve sociale, skeptikët shohin tek shtetet kombëtare një kundërgjendim për një model të përbashkët. Sipas përvojës, delegimi i kompeten-

cave sociale shtetërore është i përcjellur me një kundërgjendim të theksuar; gjë që pasqyrohet edhe në kompetencat e mangëta sociale të Unionit. Që nga Kapitulli Social i Marrëveshjes së Amsterdimit, ato u zgjerruan shkallë-shkallë. Për më tepër, që nga viti 2000, në kuadër të metodës së hapur të koordinimit, manifestohet në mënyrë të shtuar edhe koordinimi socio-politik (OMK), edhe pse, jo edhe

## Programatika partiake merr parasysh interesat socio-ekonomike të klientelës votuese

harmonizimi. Në bazë të rezultatit të shumicës së studimeve të deritanishme mbi pozicionet e partive kombëtare rreth çështjeve europiane, partitë politike në skajin e majtë dhe të djathtë të spektrit partiak, përfaqësojnë më tepër pozicione skeptike. Ndërsa partitë nga mesi i spektrit politik, preferojnë më tepër integrimin. Diferencimet e mëtejme janë të mundura brenda partive që janë të pozicionuara relativisht afër politikës së mesit. Integrimi europian është përkrahur fillimisht nga akterët konservativ si formë e „krijimit dhe hapjes së tregut“. Disa autorë mendojnë që përparimet integrative në 20 vitet e fundit drejt standardeve elementare, infrastrukturës dhe ndikimeve të shpërndarjes, akceptohen më tepër nga akterët të mesëm – të majtë. Me këtë është realizuar një shëndërrim në preferencat partiake në mesin e spektrit të majtë dhe të djathtë partiak: Në fillim të shekullit 21, partitë e mesit të majtë me gjasë kishin preferenca më të forta se sa partitë e mesit të djathtë.

Po të vërehej një pozicion i harmonizuar brenda familjeve-partiake në shtetet e UE-së, pavarësisht nga parakushtet e ndryshme institucionale dhe politike, kjo do të ishte një vërtetim që interesat partiake dominohen nga ndryshimet institucionale dhe interesat kombëtare. Kjo tezë buron nga hipoteza mbi diferencat partiake („Partisan Theory“). Argumenti i saj kryesor i referohet krahasimit të pozicioneve të të majtëve dhe atyre [që i afrohen konceptit] qytetar (bürgerlich). Shpjegimi i kësaj diference mbështetet në ndryshimet e interesave (objektive) dhe preferencave (subjektive) të votuesëve të një partie e që pasqyrohet në politikën (-qeverisëse) të këtyre partive (Hibbs 1977, krahaso poashtu Schmidt 1983; Cameron 1985; Budge/Keman 1990; Boix 1998). Nëse qëndron lidhshmëria në mes të programatikës të politikës partiake dhe interesave socio-ekonomik të klientelës së tyre votuese („Partisan Theory“), atëherë do duhej që, gjatë një krahasimi të pozicioneve të socialde-

mokratëve në vendet e ndryshme, të konstatohet një përpuethshmëri e lartë në mes tyre. Duhet të merret poashtu parrasysh që, klinteli votues i partive socialdemokrate në Europë i përket në esencë shtresave socio-ekonomike me interesa të ngjashme.

Mbetet të pritët edhe një gjë: Sa më konkrete të jetë përmbajtja e pyetjeve gjegj. propozimi i diskutuar politik, aq më shumë dalin në pah ndryshimet në përbërjen respektive të grup-klientevele-

votuese kombëtare, si dhe divergjencat reflektuese të interesit në ambientet respektive institucionale.

Në vazhdim do të paraqiten status quo-ja dhe propozimet për reforma në tri fusha: ekonomi, politik sociale dhe konkurrencë ndërshtetërore. Pastaj do të hulumtohen pozicionet e partive, sindikatave dhe shoqatave të punëdhënësëve në raport me diferencat e majta dhe të djathta si dhe ndryshimet eventuale të grupimeve të vendeve.<sup>2</sup>

## Gjendja e debatit mbi politikën ekonomike

Në mënyrë që ta përshpejtojë zhvillimin ekonomik, UE ka në të gjitha fushat në dispozicion instrumente të ndryshme. Kështu që të gjitha instrumentet drejtuese makroekonomike europiane janë të aplikueshme.

### A është SWP tejet restriktive?

Pakti i Stabilitetit dhe Zhvillimit (SWP) është posaqërisht në fokus të kritikës shkaku i "gasjes-one-size-fits-all", i cili shpesh kritikohet të jetë tejet restriktiv (posaqërisht shkaku i rregullimit deficitar 3%). Në njëërën anë, propozimet për zgjidhjen e këtij problemi orientohen drejt integritit të mëtutjeshëm ekonomik, në mënyrë që të kufizohen ciklet konjunkturale. Propozimet tjera preferojnë të marrin parasysh parakushtet nga deficitit i përgjithshëm në UE sipas specifikave të vendeve (Buti/Nava 2003). Një tjetër pikë kritikuese ndaj SWP-së është ndikimi pro-ciklik i kriterëve të tij. Në këtë kontekst, një qëndrim i rëndësishëm reformues është konsiderimi i llojit të deficitit, do të thotë një vlerësim i diferencuar i borxheve për investimet të cilat janë në harmoni me strategjinë e Lisbonës krahas borxheve për qëllime konsumi. Është poashtu e mundshme që të marrin parasysh edhe kuotat kombëtare të kursimit dhe deficitet buxhetore. Ka edhe kundërshtime ndaj kritikës kundër SWP-së, që ai është restriktiv, pra: që të eliminohet rregulla për 3%-shin dhe në vend të saj të ketë koncentrim në rregullën e 60%-shit mbi nivelin e marrjes së borxheve.

### A duhet politika e parave ta mbështes rritjen?

Diskursi i Bankës Qëndrore Europiane (BQE), rreth politikës së parave, oscilon brenda hapsirës së perceptimeve strikte të mandatit të saj për të siguruar vlerën e parave (caku i inflacionit nën 2%), si dhe një eksponimi të orientuar drejt caqeve të politikës ekonomike dhe punësuese të UE-së. Një linjë qëndrore e kritikës i drejtohet fokusit të stabilitetit të çmimëve të BQE-së, prej nga edhe rrjedhë një formulim i ri i detyrave të saj për stabilitet të çmimëve dhe qëllimeve konjunkturale. Po ashtu kritikohet edhe caku i paqartë i inflacionit, prej nga edhe përpilohen opsionet reformuese të një vlerësimi simetrik qoftë të shkallës së ultë qoftë asaj të lartë të inflacionit, gjegj. një caku afatmesëm prej 2%.

### A janë pagat kosto apo fuqi blerëse?

Gjatë debatit rreth të ardhmës së një politike europiane të pagave, dy qëndrime të ndryshme politiko-ekonomike i qëndrojnë përball njëra tjetrës. Orientimi mbizotërues ofertues përpiket për mbajtje të pagave dhe njëkohësisht për procese të decentralizuara të kërkimit për paga. Përfaqësuesit e pozicionit të orientuar drejt kërkesave, e shohin si të nevojshëm koordinimin e negociatave për paga në nivel kombëtar dhe të gjithë Unionit Ekonomik Europian (UEE). Linja qëndrore në këtë mjedis politik,

<sup>2</sup> Janë krijuar pesë grupe: një europiano-kontinentale, skandinave, angelsaksone, mediterane, si dhe lindoro- e mesme-europiane. Parametri kryesor për tipet e shteteve sociale është shkalla e dokomodifikimit, pra, përmasa e shkëputjes së sferave jetësore nga rregullimi i tregut, dhe me qëllim të mbrojtjes së qytetarit, "të liruar nga tregu".



është koordinimi i mangët i vendimeve mbi pagat, ku, si pasojë, duhet të avansohet forcimi i dialogut makroekonomik në mes të BQE-së (EZB), autoriteve fiskale dhe partnerëve social, si dhe të forcohet aftësia organizative e sindikatave, gjegjë. decentralizimi dhe diferencimi i vendimeve mbi pagat.

## Sa ka nevojë për koordinim të politikës ekonomike dhe sa është ai i dëshirueshëm?

Një politik tjetër e zhvillimit është edhe Strategjia Europiane e Punësimit (që nga viti 1997) dhe Strategjia e Lisbonës (që nga viti 2000). Sipas Strategjisë së Lisbonës, Europa do të duhej të ngritej në "hapsirën ekonomike më të aftë konkurrese dhe më dinamike në botë." Përmes qëllimeve të ndërlydhura të linjave udhërrëfyese të punësimit dhe Strategjisë së Lisbonës, ekziston një pajtueshmëri e gjërë: zvogëlimi i papunësisë, ngritja e kuotës së punësimit, ngritja e punësimit të femrave, zvogëlimi i papunësisë tek të rinjtë dhe personave me mungesë të gjatë punësimi, krijimi i vendeve më të mira të punës, përmirësimi i arsimimit, zgjerimi i përkujdesjes për fëmijët, etj. Gjatë "rishikimit afatmesëm" përmes Komisionit Europian në pranverën e vitit 2005, qëllimet janë vlerësuar si të drejta dhe të mira. Megjithatë, duhet ende kohë e gjatë që ato

të plotësohen në tërësi. Si pasojë e këtij konkludim burojnë edhe kritikët, ku, si pasojë e anashkalimit të qëllimeve, do të përpilohen edhe forma më të rrepta të udhëheqjes, në vend të Metodës së Koordinimit (OMK): forcimi i diskurseve publike përmes përfshirjes së partnerëve social dhe parlamenteve kombëtare, ndryshimi i SWP-së, për aq sa i pengon qëllimet, apo përputhja e qëllimeve kuantitative me indikatorët kualitativ (p.sh. numrin e femrave të punësuar, diferencave në paga dhe pjesëmarrja e të punësuarëve me orar të përgjysmuar).

Çështja e koordinimit europian të politikave ekonomike të vendeve anëtare është e lidhur me të gjitha fushat politike. Si hapë i parë drejt një koordinimi makroekonomik, që nga viti 1993 formulohen "karakteristikat elementare të politikës ekonomike", ndërsa, në vitin 1999, me një iniciativë gjermano-franceze, është inicuar "Procesi i Kölnit" ("Kölner Prozess"). Megjithatë, nuk ka mundësi sanksionuese, ndërsa dialogu, deri më tani, nuk shpiu deri te rezultatet e pritura pozitive në formë të një ngritje më të lartë të trendeve. Për këtë arsye, një nismë reformuese do të ishte krijimi i kompetencave më të forta vendimmarrëse dhe vendimeve obliguese të dialogut makroekonomik. Një kritikë fundamentale i drejtohet orientimit teoriko-ekonomik të koordinimit dhe kërkon një politik ekonomike neokeynesiane të makroekonomisë, duke ruajtur format e tanishme të koordinimit.

## Çfarë mendimi kanë grupet e interesit? Pozicionet rreth modelit ekonomik

Sipas personaliteteve të pyetura udhëheqëse, në vendet europiane ekziston pajtueshmëria për sa i përket nevojës parimore për një rregullator të politikës fiskale në EU. Mirëpo, për formën konkrete të pakos për stabilitetin dhe zhvillim, është shprehur kritik. Kritika kryesore është bërë për fleksibilitet të mangshëm; përveç kësaj, ka pasur ankesa edhe për impulset e pakëta për zhvillimin, të cilat rrodhën nga Pakti për Stabilitet dhe Zhvillim. Me përjashtim të partive liberale dhe disa partive të Europës Lindore (parasëgjithash nga Polonia), paktit i

atestohet edhe një ndikim problematik pro-ciklik. Ciklet e ndryshme konjunkturale në UE merren, nga një shumicë relative, si një problem për UE-në, parasëgjithash nga ana e partive socialdemokrate dhe sindikatave. Asgjëmangut, afërsisht 40 përqind e shohin përgjithësisht si të joefektshëm instrumentin e një politike konjunkturale të shteteve kombëtare. Në rastin e vendeve skandinave dhe anglosaksone, ky qëndrim paraqet një kundërtënie të qartë, dhe në vend të kësaj ende theksohet hapsira ekzistuese udhëheqëse dhe zhvillimore kombëtare.

Puna e deritanishme e BQE-së (EZB), vlerësohet nga një shumicë e qartë si e sukseshme. Ndërsa zërat kritik për këtë vijnë parasëgjithash nga ana e sindikatave, të cilat e fajsojnë Bankën Qendrore për një lënie pas dore të qëllimeve zhvillimore. Strategjisë Europiane të Punësimit (EBS) i dëshmoheh kryesisht një ndikim i ulët në marrjen e masave kombëtare. Vetëm në grupin e shteteve mediterane, gjysma e të anketuarëve kanë dhënë përgjigje pozitive në pyetjen rreth lidhshmërisë direkte me reformat e politikave punësuese në vendin e tyre. Një pamje tjetër ofron Strategjia e

Lisbonës. Përgjithësisht, të gjitha partitë i shohin qëllimet e formuluar në të drejta, edhe pse partitë socialdemokrate janë paksa më skeptike. Ato parasëgjithash e qortojnë koncentrimin e qëllimeve ekonomike, pasi të jetë bërë korigjimi në vitin 2005. Konsensi ekziston tek gjitha partitë dhe të gjitha vendet, sa i përket vlerësimit të rezultateve të deritanishme që i ka treguar Strategjia e Lisbonës. Pavarësisht nga ky vlerësim kritik, qoftë sa i përket rezultateve të BQE-së, qoftë të Strategjisë së Lisbonës, OMK-ja akceptohet përkushtimisht.

## Cilat janë propozimet e partive dhe shoqatave për reformimin e politikës ekonomike?


Prej opsioneve të cilat qarkullojnë rreth debatit reformues për paktin stabilizues dhe zhvillimor, ceket parasëgjithash përfillja e diferencuar e investimeve, si mjet kundër jo-fleksibilitetit dhe për një orientim më të fortë drejt zhvillimit ekonomik. Megjithatë, në disa vende refuzohet të ketë prap ndryshime dhe në vend të kësaj theksohet respektimi i rregullave nga të gjitha vendet (Finland, Poloni, Slovaki). Sa i përket definicionit, vendet e Europës Lindore si dhe Holanda, presin që të ketë vetëm mospajtueshmëri në mes të vendeve anëtare sa i përket përfilljes së investimeve për definimin e kriterëve të deficiteve. Për këtë arsye, Italia, Greqia dhe Irlanda propozojnë të ketë lidhshmëri me caqet e Strategjisë së Lisbonës. Në këto propozime për reforma ekzistojnë pozicione të ndryshme, parasëgjithash në mes të vendeve, gjegj. grupeve të vendeve. Dallime në mes të partive, të cilat vlejnjë të cekën, nuk ekzistojnë (Fig. 1)

Një pamje krejt tjetër paraqitet tek reforma e mandatit të BQE-së. Derisa socialdemokratët (dhe sindikatat) e përkrahin një mandat të ri, shumica e konservativëve dhe liberalëve janë kundër këtij propozimi. Të pyetur për ndërrimin e cakut të inflacionit, shumica e krahut të sindikatave shprehen për një cak më të lartë të inflacionit. Asgjëmangut, pak më shumë se një e treta e partive socialdemokrate, janë poashtu për një cak më të lartë të inflacionit, derisa një shumicë e qartë e konservativëve dhe liberalëve janë të kënaqur me një status quo.

Është në rritje e sipër apeli për një politikë më të fortë të koordinimit të pagave, si një çështje që zë vend të posaçëm dhe qëndror ekonomik në nivelin europian. Një shumicë e qartë e refuzon këtë thelbësisht, ndërsa një e pesta, mund ta paramendojë këtë në një të ardhme të largët. Ky propozim, në mesin e partive socialdemokrate, gëzon një përkrahje të qartë (mbi një e treta), në krahasim me ato konservative (nën 10%). Koordinimi gjithpërfshirës i politikës së pagave brenda UE-së gjenë përkrahje të lartë vetëm te grupi i vendeve mediterane, ndërsa, një refuzim i plotë për këtë ide, vjenë nga vendet anglosaksone dhe skandinave. Ky qëndrim i përbashkët i Britanisë së Madhe, Irlandës dhe vendeve skandinave, duhet të shiqohet nga sfondi i sistemeve të ndryshme negociuese për paga. Derisa në Irlandë dhe vendet skandinave, sistemi i paprekur i negociimit të pagave përdoret si argument, socialdemokratët dhe sindikatat në Britani të Madhe, janë parimisht skeptik ndaj transferimit të kompetencave në nivel europian; në vend të kësaj, si nivel i preferuar, cekët niveli ndërmarrës i negociimit të pagave. Në vendet e tjera, shumica e socialdemokratëve dhe sindikatave janë të mendimit që pagat do të duhej të negocioheshin në nivel kombëtar, derisa konservativët dhe liberalët preferojnë decentralizim të mëtejshëm në nivel të ndërmarrjeve.

Propozimi për koordinim më të fortë të paracaktimeve më të forta obliguese të UE-së në politi-





**Fig. 1: Reforma e paktit për stabilitet dhe zhvillim**

kë të punësimit, hasë në skepticizëm të shumicës. Këtu paraqiten edhe më qartë vendet-???? (shiqo tekstin origjinal, f. 9, par. i fundit?!). Një koordinim më i fortë, gjenë përkrahje të madhe në vendet mediterane. Ndërsa, ky propozim, hasë në refuzim tejpatriak në vendet skandinave dhe Britani të Madhe. Megjithatë, sa i përket çështjes së koordinimit më të fortë të politikës së punësimit vlenë edhe në këtë rast që, këto masa i përkrahin vetëm partitë socialdemokrate dhe sindikatave, ndërsa refuzohen qartë nga partitë konservative dhe liberale.

Përveç reformave të përmendura, ka poashtu këkesa për instrumente të reja në politikën ekonomike të UE-së. Relativisht afër status quo-së, është propozimi për një zgjerim të "Broad econo-

mic Policy Guidelines", për një perspektivë afatshkurtë koordinuese. Ky propozim hasë në, qoftë përkrahje qoftë refuzim të drejtpeshuar, përdërisa, në mes të partive dalin në pah diferenca të qarta. Propozimi refuzohet plotësisht nga konservativët dhe shoqatat e punëdhënësëve, ndërsa shumica e sindikatave dhe socialdemokratëve janë për te.

Masat anticiklike të UE-së ishin instrument plotësisht i ri ekonomiko-politik. Edhe këtu vijnë në shprehje diferencat brenda boshteve të majta dhe djathta. Përveç refuzimit nga ana e konservativëve, liberalëve dhe shoqatave të punëdhënësëve, poashtu edhe krahu i sindikatave është i ndarë në këtë rast. Brenda grupit të socialdemokratëve, prap janë partitë skandinave të cilat deklarohen

kundër masave anticiklike të UE-së. Si arsye është përmendur refuzimi i një buxheti të UE-së në ngritje e sipër, gjë që do të ishte kusht i domosdoshëm për një propozim të tillë (shih Fig. 2).

Një hap më tutje shkon propozimi për një koordinim makroekonomik brenda për brenda UE-së. Edhe në këtë rast përkrahja e përgjithshme është e drejtëpeshuar, ndërsa mostra në mes të partive dhe vendeve afërsisht identike me pozicionimet për masat anticiklike: refuzim i qartë vjen

nga konservativët, liberalët dhe shoqatat e punëdhënësve, derisa ka përkrahje nga shumica në mesin e socialdemokratëve dhe sindikatave. Edhe kësaj radhe, zërat që në mesin e socialdemokratëve kundërshtojnë, vijnë nga vendet skandinave. Një transfer i kompetencave ekonomiko-politike (posaçërisht fiskalo-politike dhe i politikës së pagave) në nivel të UE-së, refuzohet përgjithësisht. Ndërsa një koordinim vullnetar nga 25 vendet vlerësohet si jo-real.




Fig. 2: Masat anticklike në UE



# Gjendja e debatit mbi politikën sociale

## A janë të gatshëm t'i kalojnë kompetencat shtetërore?

Politika aktuale sociale e UE-së e ka bazën e vetë në Marrëveshjen e Amsterdimit. Politika sociale rradhitet në përgjegjësitë e përbashkëta të Bashkësisë Europiane dhe vendeve anëtare. Deri më tani politika sociale, si fushë e politikës, i nënshrohet rregulloreve të lehtësuara dhe direktivave. Derisa në fushën e të drejtës së punës Europa shfaqë një dimension të dallueshëm social (standardet minimale), rregulloret në fushën e shërbimeve dhe sistemeve sociale ose nuk ekzistojnë fare ose përbëhen vetëm nga direktivat. Deri më tani në sferat sociale dominon aplikimi i OMK-së.

Rekomandimet dhe marrëveshjet civile në sferën e politikës sociale janë gjithnjë të lidhura me kriteret e SWP-së dhe politikës së parave të BQE-së (Scharpf: 2002). Në këtë mënyrë, është e dëshirueshme ose shkëputja e OMK-së përmes rregulloreve të "ashpra" dhe/ose përcaktimi i një kufiri të ulët për të dhënat sociale të matura me prodhimin e përgjithshëm kombëtar. Është i imagjinueshëm edhe inkorporimi i standardeve politiko-sociale në SWP dhe/ose inkorporimi i të drejtave sociale në Kartën mbi të drejtat bazë. Një pozicion ekstrem vlerëson që heterogjeniteti i shteteve me mirëqenie të lartë pamundëson një politik të përbashkët sociale dhe kjo sferë duhet të organizohet mbi baza shtetërore kombëtare.

## A i mbingarkon migrimi sistemet kombëtare sociale?

Zgjerimi i UE-së në Lindje sjell frikë, pasi që lëvizjet migruese nga shtetet e reja anëtare mund t'i mbingarkojnë sistemet sociale. Kjo frikë gjenë arsytet e vetë në detyrimin e përdorimit të sistemeve të sigurimit social për të gjithë punëmarrësit dhe familjet e tyre të cilët migrojnë brenda UE-së. Përgjigjet për këtë gjenden në mes të proteksionizmit dhe liberalizimit të mëtutjeshëm ("zëmërgjërësia e punëmarrësëve").

Mbi baza të këtij dhe sfondit të një "zbrazjeje pagash" (Lohndumping), është e mundshme futja e një mase socialo-politike për një pagë minimale europiane e cila kërkohet pavarësisht nga çështja e nivelit të negociatave për paga. Derisa në shumicën e vendeve të UE-së ekziston një rrogë minimale, posaqërisht sindikatat gjermane e shohin këtë si një rrezikim të autonomisë tarifore.

## Dialogu me partnerët social – një ndër shtyllat qendrore të modelit social europian

Për këtë qëllim, Komisioni dhe partnerët social hartuan një procedurë të dialogut të përhershëm, i cili drejtohet nga përfaqësuesit udhëheqës të shoqatave të punëdhënësëve (UNICE dhe CEEP) dhe lidhjes së sindikatave (EGB). Në suaza të këtij dialogu do të përpilohen pozicione në fushën e arsimit dhe edukimit, të organizimit të tregut të punës si dhe kahja e politikës ekonomike. Në fushën e punësimit, në qendër të vëmendjes së strategjisë së punësimit, qëndron pjesëmarrja aktive e partnerëve social. Për ta përkrahur dialogun social në nivelin e ndërmarrjeve, në vitin 1994 është ratifikuar direktiva për Përfaqësinë Europiane të Punonjësëve (EBR). Ky gremium, i orientuar parasëgjithash në informim dhe konsultim, tashmë është instaluar në më se 40% të ndërmarrjeve të cilat i përkasin direktivës në fjalë. Kritika qendrore ndaj dialogut social është një mungesë e drejtpehimit në mes të partnerëve social përmes një të drejte faktike të punëdhënësit për veto. Për këtë arsye, njëra nga kërkesat përbëhet në forcimin e aktiviteteve të Komisionit, në mënyrë që të ngriten interesat e punëdhënësëve në dialogën social. Një opsion i mëtutjeshëm është përfshirja e partnerëve social në procedurat vendimmarrëse. Duke u ndërtuar mbi perceptimet e një zhvillimi të dobët të koordinimit në nivelin sektoral, më tutje propozohet një koordinim më i fuqishëm në mes të përfaqësive europiane të punonjësëve dhe sindikatave sektorale (Keller 2003).

## Çfarë qëndrimi kanë grupet e interesit për modelin aktual social?

Vlerësimet për modelin aktual të një „Europe sociale“ janë të ndryshme. Ashtu siç u bë e qartë në kapitullin e kaluar, parasëgjithash është shfaqur kritik për forcën ndikuese të modelit ekonomik dhe social europian. Gjatë vlerësimit të Europës social-politike, poicionet sillen që nga të pamjaftueshme (Greqi) e deri te sjelljet pozitive (Danimark). Bie në sy që, tendencialisht ato shtete, në të cilat mirëqenia shtetërore kombëtare është relativisht dobët e theksuar, kritikojnë më shumë politikën sociale të UE-së se sa që e bëjnë këtë akterët politik të shteteve me mirëqenie të ngritur. Ashtu siç është pritur, sindikatat vlerësojnë shumë më rreptë mungesën e modelit se sa që e bëjnë këtë socialdemokratët. Përfaqësuesit e punëdhënësëve madje e shohin sferën e politikës sociale të UE-së si një „sferë shumë të zhvilluar ligjore“ e cila është „pothuajse e përmbyllur“.

Në anën tjetër, mbizotëronte njëmendësi tek pothuajse të gjithë partnerët e intervistuar për sa i përket një „turizmi social“ të mundshëm si dhe migracionit për shkak të hendeqeve sociale të shteteve. Përgjithësisht syzozohet që arsye më e vogël për levizjet migruese janë dallimet në ofertat sociale të shteteve, por gjithsesi edhe mundësitë

për punësim si dhe dallimi në paga. Në vendet si Austria, e cila kufizohet me shtetet e reja anëtare, migrimi potencial merret si „sfida numër një“, qoftë nga të majtit (posaqërisht sindikatat), qoftë nga të djathtit. Në vendet e Europës Jugore, vala e migrimit vjenë parasëgjithash nga vendet që nuk janë në UE (në Greqi: nga Shqipëria dhe vendet tjera ballkanike, në Spanjë: poashtu Amerika Latine dhe Afrika Veriore). Sipas vlerësimit të përgjithshëm kjo nuk paraqet ndonjë problem, por shtrohet pyetja se sa është kjo e lavërdishme për ekonominë. Përdërisa tregu i punës përkujdeset për mundësi të mjaftueshme të punësimit migrimi nuk do të trajtohet si problem.

Dialogu social në nivel të UE-së vlerësohet tendencialisht si pozitiv, ndërsa për rezultatet e dërritanishme ka mendime të ndryshme. Sidoqoftë, parimisht është sajuar një disponim i gjërë për institucionin e një dialogu social në nivel kombëtar apo të UE-së. Nga disa shihen mardhëniet kolektive të punës si gurëthemel i modelit ekonomik dhe social europian, ndërsa nga të tjerët, si një bërthamë për zhvillimin më të fortë të një Europe sociale.



# Çfarë propozime kanë partitë dhe shoqatat për reforma në politikën sociale

## A do të vazhdojë „politika sociale“ të mbetet çështje kombëtare?

Në krahasim me partitë konservative dhe liberale si dhe shoqatave të punëdhënësëve, tek të pyeturit socialdemokrat dhe sindikal, mbizotëron mendimi i njejtë, që: dimensionit social europian i duhet një vlerësim. Sidoqoftë, ka pak pajtueshmëri sa i përket masave konkrete që kanë për qëllim krijimin e një EWSM-je të përbashkët. Me këtë lidhet heterogjeniteti i aranzhmaneve të shteteve mirëqenëse në Europë. Kjo shihet më tepër si përparësi se sa pengesë në UE. Me qëllim të mbledhjes së përvojës, tërhiqet vëmendja relativisht qartë për një garim frytdhënës në mes të vendeve me mirëqenie. Kjo vlenë parasëgjithash për vendet skandinave dhe pjesërisht shtetet anëtare. Posaqërisht në vendet anëtare, sidomos në Austri, Francë dhe vendet tjera cekët poashtu fakti që bërthama e një EWSM-je të përbashkët tashmë ekziston në formë të aranzhmaneve të harmonizuara kombëtare dhe të cilat kufizojnë me „modelin amerikan“. Në këto aranzhmane hyjnë për shembull raportet kolektive të punës, shmangja e pabarabartësisë, sigurimet publike sociale dhe të ngjashme. Për këtë arsye, shumica e të pyeturëve refuzon që në etapa të gjata ta synoj një model social europian, gjegjë. mendon se është jo real. Në vend të kësaj favorizohet një pajtim mbi „standarde minimale sociale“ apo „të drejta sociale“ në nivel europian. Brenda kësaj kornize mund shpaloen pastaj variantet kombëtare.

## Çka duhet të rregullojë paga minimale?

Mbetet relativisht e paqartë se për cilat standarde sociale mund të jetë menduar. Shembulli i pagës minimale tregon edhe në këtë rast që gjatë propozimeve konkrete rezistenca mund të jetë më e madhe. Pëlqimi për implementimin e një page minimale europiane ndryshon thelbësisht nga një grup i vendeve në tjetrin. Në vendet skandinave,

partitë e majta dhe sindikatat e kundërshtojnë këtë njëzërit. Atje mbizotëron mendimi që një rregullim i pagës minimale duhet të mbetet çështje e partnerëve social. Një ndërhyrje ligjore do ta dobësonte pozitën e partnerëve social. Përkrahja për një pagë minimale në UE është më e madhe në shtetet kontinentale të Europës, edhe pse në këtë rast, sindikatat e vendeve me partneritet të fortë social (Austri, por edhe Francë), e refuzojnë një ndërhyrje në çështjet e pagave përmes ligjëvënësit apo UE-së. Përkrahja më e madhe për një pagë minimale të UE-së vjen nga shtetet e Europës Jugore, Britania e Madhe dhe Irlanda. Varianta e cila gjenë më së shumti përkrahje është ajo e cila parasheh miratimin e pagës minimale në nivel të UE-së, që do të implementohej pastaj veç e veç përmes pagave minimale. Tendencialisht është gjendja ashtu që, paga minimale refuzohet, qoftë në shtetet Lindore si dhe shtetet me mirëqenie të zhvilluar dhe partneritet të zhvilluar social (Europa kontinentale dhe Skandinavia).

Si mezo-rezultat, mund të konstatohet që pozicionet e partive dhe organizatave të pyetura, mvarren thelbësisht nga shkalla e konkretizimit. Shiquar nga një rrafsh abstrakt, përkrahja për një „Europë më sociale“ është gjërë e shpërndarë në mesin e partive politike të majta. Kjo e përkrah tendencialisht hipotezën, e cila rrjedh nga pikënisja që interesat partiake i dominojnë interesat kombëtare-shtetërore. Sidoqoftë, kur të cekën zgjidhjet specifike politike (siç është rasti me miratimin e pagës minimale), atëherë dalin në pah përçarje të qarta përgjatë grupeve të vendeve si dhe një përmbajtje e sforcuar sa i përket kalimit të kompetencave politiko-sociale tek niveli suprakombëtar.

## Dialogu social: si duhet të jetë i përbërë konkretisht?

Në mesin e të pyeturëve mbizotëron një qëndrim i pandarë pozitiv për institucionin e Dialogut Social dhe të Partneritetit Social, njëherit, sëndërtimi konkret në nivel të UE-së megjithatë vlerësohet pak më ndryshe. Një shumicë e gjërë, posaqërisht

nga radhët e socialdemokratëve dhe sindikatave, favorizon mendimin që, në të ardhmën, partnerët social duhet të kenë një rolë më të fuqishëm në UE. Megjithatë, mbizotëron një mospajtim i konsiderueshëm sa i përket çështjes se si mund të vihet deri te një sforcim i ndikimit të partnerëve social, parasëgjithash sindikatave. Nga ana e sindikatave ceket parreshtur qëndrimi bllokues i organizatave të punëdhënësëve. Përveç kësaj, siç është vërejtur nga ana e një partneri të intervistuar nga Danimarka, organizatat e punëdhënësëve nuk posedojnë resurse organizative në një numër të konsiderueshëm të shteteve të UE-së, gjegjë. fuqinë për të depërtuar tek anëtarët e vet, në mënyrë që nga ana e partnerëve social t'i implementojnë vërtet politikat e miratuara bashkarisht. Edhe më tej është shprehur kritika (në Spanjë dhe Greqi) rreth asaj që, Komisioni, si „arsyetim për mosangazhim“, e përdorë bllokadën reth dialogut social dhe në këtë mënyrë nuk bëhet më aktiv. Mendimet ndahen posaqërisht rreth forcimit të ndikimit të sindikata-

ve. Një shumicë relative parapëlqen një rolë më të fortë të Komisionit, i cili duhet t'i delegoj „detyrat“ për një veprim, pothuajse-ligjor, tek partnerët social si dhe të ushtroj më tepër trysni mbi punëmarrësit, në mënyrë që ata të obligohen për një qëndrim më kooperativ. Një pakicë e pyetur, parasëgjithash sindikatat me traditë sindikaliste dhe një bazë të fortë organizative, refuzon një fuqizim të rolit të Komisionit: Një fuqizim i rolit dhe pozicionit të sindikatave duhet të arrihet duke buruar nga lëvizja sindikale. Mbështetja për përmirësimin e koordinimit në mes të përfaqësive europiane të psunonjësëve dhe sindikatave kombëtare, kërkohet parasëgjithash nga ana e sindikatave, ndërsa më pak nga partitë e majta.

Poashtu edhe sa i përket temës së „Dialogut Social“, dalin në pah vijat e njohura konfrontuese: përkrahje e lartë për një rrafsh abstrakt dhe përkrahje për institucionin si të tillë, mirëpo një mospajtueshmëri e madhe sa i përket çështjeve për politikat dhe strategjitë konkrete.

## Gjendja e debatit mbi aftësinë konkurruese

Përkundër diskursit publik mbi analogjinë e UE-së me shtetet federale, kompetencat e UE-së janë shumë më mbrapa në krahasim me ato të cilat i posedon përfaqësia federale në sistemet federale. Përveç kësaj, identiteti evropian është i theksuar shumë dobët. Sidoqoftë, që të dyja janë faktorë të rëndësishëm për ta kapluar problemin e konkurrencës shtetërore-kombëtare në sferat relevante qëndrore shpërndarëse, siç janë politika agrare dhe strukturale. Gara për tatim brenda Unionit është poashtu shprehje e konkurrencës kombëtareo-shtetërore, përmes së cilës, me konkurrencë të ofertës më të ulët, krijohen shtytje për investicione.

### A shpie kompetenca kombëtare mbi tatimin në dumping?

Tatimet vazhdojnë të mbesin pjesa bërthamore e sovranitetit kombëtar. Deri më tani, politika tatimore e UE-së, në kontekst të harmonizimit të tregut të brendshëm, është kryesisht e mbështetur në përqindjen tatimore të tatimeve indirekte (si tatimeve në vlerë të shtuar dhe tatimeve të konsu-

mit). Përveç kësaj, buxheti i bashkësisë financohet pjesërisht nga të ardhurat prej tatimit në vlerë të shtuar. Për këtë arsye, peshja e kontributit duhet të shpërndahet në mënyrë të drejtë tek të gjitha shtetet anëtare të UE-së.

Duke marrë parasysh që gara për tatimin e ndërmarrjeve në mënyrë të shtuar po i kalon kufijtë, UE tashmë ka filluar të ballafaqohet edhe me këtë fushë. Pas zgjerimit të UE-së në lindje, në këtë fushë u rrit numri i shteteve me përqindje të ulët tatimore. Një garë e tillë nga ana e shteteve me përqindje të lartë të tatimit, kritikohet ndonjëherë si „dumping i tatimeve“. Deri më tani ishte vështirë që të vlerësohen rezultatet e përvetshme dhe të përgjithshme rreth garës tatimore. Si masa të mundëshme reformuese në nivel evropian kërkohen: përqindje minimale tatimore, një tatim i konsoliduar ndërmarrës për ndërmarrje transnacionale, një tatim i UE-së mbi transaksionet financiare dhe një tatim i UE-së mbi të ardhura kapitale. Për arsye të problemit perceptues të një harmonizimi të mangët, është menduar që bartja e çështjeve të tatimeve me parim të shumicës (në vend të kër-



kesës për konsensus) të bëhet në këshillin ministror. Poashtu është menduar në rritjen e kompetencave të UE-së për vjelje të tatimeve.

## Politika agrare: joeficienca e zgjidhjeve të deritanishme në UE

Një fushë e mëtejme e konkurimit ndërshtetëror është edhe politika agrare. Buxheti agrar, me 45 % të daljeve, është buxheti më i madhë i pjesërishëm i UE-së. Politika e përbashkët agrare (GAP) është e vetmja fushë e Unionit Europian e unisuar plotësisht. Diskursi në këtë fushë politike ka të bëjë me atë se a duhet UE-ja edhe më tutje t'i fokusoj harxhimet më të mëdha në politikën agrare, çfarë drejtimi duhet të marrin pagesat dhe si duhet të veprohet pas ngritjes së nevojave për mjete, si pasojë e zgjerimit në lindje. Një kritik e sheh GAP-in si një sistem joeficient me joshje false i cili duhet të decentralizohet (ri-kombëtarizimi). Rreth argumentit të çmimit propozohet që duke kaluar koha të reduktohen pagesat, të ketë ndikim për ko-financim përmes shteteve anëtare apo të koncentrohet financimi i UE-së në zhvillimin e hapsirës rurale.<sup>3</sup>

## Politika strukturore bëhet e shtrenjtë

Politika strukturore do të duhej ti shërbente forcimit të bashkallëkut ekonomik dhe social në bashkësi dhe duke bërë këtë, ta avansojë posaqërisht zhvillimin dhe punësimin në regjionet më

pak të zhvilluara. Një kritik qenësore i drejtohet eficiencës së përkrahjes regjionale. Puna e reformave sillet që nga heqja e avansimit e deri tek rreptësimi i qartë i kritireve përzgjedhëse, apo fokusimi në projekte të veçanta dhe zona metropolitane të zhvillimit. Propozimet e moderuara tentojnë për ko-financim përmes mjeteve kombëtare, apo të zavendësohet veprimi regjional me atë kombëtar me qëllim të ngritjes së institucioneve për hulumtime, zhvillim, arsimim dhe infrastruktur. Për tu tejkaluar mungesa e mjeteve pas zgjerimit në lindje, punohet në ngritje të buxhetit të UE-së apo rreptësimi të kritereve për para për struktura.

Aspekti i konkurimit vie posaqërisht në pah përgjatë formimit të një tregu të harmonizuar të brendshëm të UE-së për shërbime. Pas propozimit të Komisionit më 13 janar 2004, ky barazim arrihet parasëgjithash përmes shkarkimit të rregullave kombëtare, që figuron nën të ashtuquajturin parim të prejardhjes së një vendi.<sup>4</sup>

Në diskursin politik dhe shkencor është kontestuese se çfarë konsekuencash për secilin shtet anëtar do të kishte futja e kësaj direktive. Është kritikuar një "race to the bottom" i mundshëm, sa i përket standardeve të punës, atyre sociale, kualitative dhe ambientale, për ç'arsye është kërkuar të eliminohet parimi i vendit prejardhës, gjegjë futja eventuale e tij pas një harmonizimi afatgjatë. Poashtu është kritikuar termi i paqartë për shërbime, si pasojë është kërkuar një listë pozitive dhe përjashtimet për shërbimet në shëndetësi, mirëqenie dhe shërbime sociale.

# Si e shohin grupet e interesit politikën e përmirësimit të konkurimit?

## Edhe një herë dumpingu i tatimit

Jo vetëm nga të majtit europian, por edhe nga ana e shumicës së qartë të partive konservative merret parasysh gara e rreptë e tatimit pas zgjerimit të UE-së në lindje. Ky perceptim përshatatet me shifrat e dhëna. Kështu që, diferenciali

tarifor i përqindjes tatimore mbi tatimin në fitim tek shoqatat kapitale, qëndron mesatarisht në dhjetë përqind-pikë në mes të shteteve të vjetra dhe dhjetë anëtarëve të rinjë. Se a do vihet deri te zhvendosja e vendimeve për investime pas këtyre ndryshimeve, të cilat sipas saldoshkojnë në harxhimet e shteteve të vjetra anëtare, nuk kon-

<sup>3</sup> Politika agrare e UE-së përbëhet nga tri fusha: Intervenimet në treg, pagesat direkte dhe pagesat për zhvillimin e hapsirës fshatare ("shtylla e dytë"). Pagesat direkte me 30% të buxhetit të UE-së, paraqesin postin më të madhë buxhetor.

<sup>4</sup> Për veprime të përkohshme tejkufitare, për ofertuesin e shërbimeve duhet të vlejnjë rregullat e vendit prejardhës, të lidhura me një ndalesë përmbajtësore për pengesa ndaj vendit pranues. Kontrollimi dhe mbikqyrja e ofertuesit do të duhej të mvarej nga vendi prejardhës. Parimi i vendit prejardhës nuk u aprovua në Parlamentin Europian më 16 Shkurt 2006.

statohet njëzërit nga të majtit socialdemokrat në Europë. Ekzistenca e garës tatimore është e përcjellur edhe nga mëdyshjet, si p.sh. në Irland, Britani të Madhe apo Danimark, gjegj. ndikimet e saj konsiderohen si të vogla. Një garë tatimore e përkrahin vetëm ato vende, struktura dhe ekonomia e të cilave është e aftë të garojë brenda për brenda dhe kundër një gare të tillë. Sindikatat e shohin këtë aspekt me një sy kritik edhe përtej kufijëve. Ato e shohin edhe në shtetet anëtare euro-lindore "dumpingun tatimor", përderisa edhe partitë e majta artikulojnë një pozicion më të kujdesshëm për vlerësimin e politikës tatimore. Kjo vlenë edhe për sindikatat sllovaqe, ku është futur në funksion një Flax-Tax-sistem, e i cili nga shtetet e tjera të Europës Lindore kritikohet si çregullues i konkurrencës. Në Lindje, humnera në mes të sindikatave dhe partive socialdemokrate, shprehet përgjatë ndikimit të garës tatimore: Sindikatat kanë frikë nga një dëm i dobive publike ("race to the bottom"). Ndërsa partitë e të majtës demokratike janë të ndara në mendim rreth kosekuencave dhe garën e shohin si mjet legjitim të dhjetë shteteve të UE-së në mënyrë që të joshën investimet direkte nga jashtë.

## Si të ulën shpenzimet agrare?

Shpenzimet për politikën agrare vlerësohen nga shumica e partive dhe organizatave në Europë si shumë të larta. Përderisa Franca shprehë shumë pak kritik për shumën e shpenzimeve, pasi që mirëmbajtja e bujqësisë europiane është e rëndësishme elementare për arsye të sigurisë së furnizimit kombëtar dhe të mbrojtjes shëndetësore. Pozicioni i kundërt me të majtit francez vjenë nga Britania e Madhe, ku mbizotëron qëndrimi që politika agrare duhet të jetë e integruar në politikën strukturore dhe parasëgjithash duhet t'ju qëndrojë në dispozicion shteteve të reja anëtare në formë të ndimës strukturale. Shpenzimet agrare në kuptim të ngushtë të fjalës do të duhej të financoheshin nga shteti anëtar respektiv. Kritika e përbashkët e shteteve të Europës Qëndrore dhe Lindore (qoftë partive të majta qoftë sindikatave) ndaj strukturës së lartësisë të shpenzimeve të GAP, shkon edhe në një drejtim tjetër: Për shkak të përparësisë në paga në sektorin agrar dhe përshtatjes së sukseshme në struktura në vitet e fundit, prodhuesit vendor vlerësohen më të përshtatshëm për garë. Një re-

duktim i ndihmave në të gjithë UE-në, do t'i sillte bujqëve të Europës Lindore lavërdi shtesë.

Shumë më pozitiv është vlerësimi i politikës regjionale dhe strukturore të UE-së. Ajo vlerësohet nga shumica dërmuese si efiçente. Kritika e shprehur pjesërisht nga ana e shteteve të reja anëtare, ndaj byrokracisë gjatë shtrimit të kërkesave për fondet strukturore, shpejgohet edhe me ngritjen e nevojshme të rezultateve për adaptim institucional. Partitë e atjeshme të majta si dhe sindikatat, përgjithësisht i shohin transferet si instrumente të arsyeshme kohezive.

## Konkurimi në shërbime: në parim po, por si?

Një facetë e radhës në fushën e konkurimit në mes të shteteve anëtare është liberalizimi i shërbimeve. Qoftë në mesin e partive konservative dhe liberale, qoftë në mesin e partive të majta dhe sindikatave në Europë ekziston një refuzim i përgjithshëm për liberalizimin e tregut të shërbimeve, edhe pse partitë e majta janë për këtë më të vendosura se sa sindikatat. Posaqërisht shtetet e Europës së Mesme dhe Qëndrore e shohin konkurrencën në shërbime si një proces të nevojshëm për përsosshmëri të tregut të brendshëm të tyre.

Megjithatë, brenda partive të majta ka pasur një opozitë të njëzëshme për sa i përket parimit të prejardhjes shtetërore, prej të cilit është pritur një „race to the bottom“ i dëmtueshëm i dobisë publike. Një garë e tillë e uljes së çmimeve në seferën sociale, ekologjike si dhe të drejtës së punës, sjell frikë posaqërisht në Skandinavi, por edhe në vendet anglosaksone, kontinentale dhe mediterane. Vetëm në vendet e Europës Lindore ekziston për këtë një mendim i ndarë, siç u bë e qartë në disputin më të ri rreth përvetësimit të propozimit për kompromis nga ana e Parlamentit European. Te parimi i prejardhjes së vendeve, u arritën përsëri kufijtë për formimin e koalicioneve transnacionale, për arsye të perceptimit asimetrik sa i përket ndikimit të shpërndarjes. Në këtë rast përhapet humnera në mes të shteteve të vjetra dhe të reja anëtare si dhe nuk ka përpuethshmëri në modelet e shteteve për ngritje të mirëqenies. Në Europën Lindore, një rrezik të mundshëm për një rënie e shohin vetëm sindikatat, të cilat i marrin në mbrojtje standardet e përbashkëta të shërbimeve të para-kujdesjes ekzistenciale publike.



# Çfarë propozime reformuese kanë grupet e interesit?

## Politika e tatimit: shumë mendime për shumë detaje

Elzistojnë dallime të mëdha në çështjen e ballafaqimit të drejtë me konkurimin tatimor (participues). Aplikimi i parimit të shumicës në Këshillin Ministror për çështje të tatimeve nuk gjënë përkrahje nga shumica. Nëse deklarohen partitë socialdemokrate, siç është rasti me Finlandën, për një kuotë të tillë reformuese, atëherë vetëm me një kufizim të qartë të kompetencave të UE-së për çështjet e tatimeve. Kalimi prej parimit të njëzëshëm në atë të shumicës për çështje të tatimit gjenë përkrahje vetëm te socialdemokratët e Europës Kontinentale dhe Juglindore. Derisa Standinavët nuk kanë një pozicion të përbashkët, në anën tjetër europianët lindor, britët dhe Irlandezët janë qartazi kundër. Në mesin e partive konservative dhe liberale si dhe shoqatave të punëdhënësëve, ky propozim hasë në një kundërshtim të njëzëshëm.

Në lidhje me këtë çështje nuk rezultoi poashtu asnjë koalicion transnacional i majtë, pasi që përmes një hapi të tillë institucional, edhe pse në fakt një opsion i standardit minimal për çështje të tatimeve do të ishte i pranishëm, do të mungonte garanca. Është poashtu e mundur që të inicohet një zhvillim i kundërt dhe konkurenca tatimore të forcohet edhe më shumë institucionalisht. Sindikatat në Europë nëkuptojnë me këtë synim më tepër një hap të rregulluar integruar, për çka edhe përkrahin si shumicë një reform të Këshillit Ministror.






Vota refuzimi erdhën parasëgjithash nga vendet e Europës Lindore, të cilat nuk janë të gatshme t'ia kalojnë nivelit të UE-së kompetencat e mëtutjeshme për çështje të tatimit. Me këtë, këto vende kuptojnë shumë më shumë një synim të fshehur të shteteve të vjetra anëtare për harmonizim. Fundja, përmes zgjerimit është rritur edhe kërkesa për konsens në Këshillin Ministror, rrjedhimisht edhe një argument shtesë kundër vendimeve shumicë për çështjet tatimore. Sa i përket këtij aspekti, vërtetohet teza që mund të vërehen njësi relativisht të pavarura të vendeve sa i përket botkuptimeve të tyre, sidomos kur masat në nivel të UE-së kanë

si pasojë rezultim të ndryshëm të shpërndarjes, gjegjë kur kuptohen si të tilla.

Në anën tjetër, një pajtueshmëri më e gjërë ekziston në mesin e partive të majta dhe sindikatave të Europës, sa i përket çështjes se a duhet të rriten kompetecat tatimore të Komisionit të UE-së. Për një masë në kontekst të garës tatimore, ato u shprehen kundër me një shumicë të qartë. Më paradigmatic është qëndrimi i partive irlandeze, të cilat janë kundër ngatërimit të kompetencave të politikës tatimore në nivel të UE-së, pasi që qeveritë kombëtare nuk do të posedonin më mundësi udhëheqjeje gjatë periudhave recesive (përveç shkurtimit të shpërndarjeve). Sa i përket këtij pozicioni, partitë socialdemokrate të Italisë paraqesin një përjashtim. Ato mund ta paramendojnë një parim të shumicës qoftë në Këshillin Ministror qoftë kalimin e kompetencave tatimore në nivel të Komisionit të UE-së. Me këtë lidhet vizioni dominant brenda partive të majta në Itali që UE-ja të ndërtohet në një shtet federativ. Ndërsa në Poloni, sindikatat mbajnë qëndrim pozitiv për ndërthurje të kompetencave, derisa socialdemokratët janë kundër. Përgjithësisht ekziston disponimi i refuzimit të kësaj mase, gjë që mund të vlerësohet si një pozicion tejshtetëror i partive.

Një opsion qëndror për reforma të përgjithshme europiane në garën tatimore është futja e një përqindjeje minimale tatimore për tatimet e ndërmarrjeve apo harmonizimi i bazës matëse. Një shumicë pajtohet me rregullimin e tatimit të ndërmarrjeve, edhe pse nuk ka shumicë të qartë për një tatim-vjelje minimale europiane, pasi që një numër i partive socialdemokrate dhe sindikatave koncentrohen në një bazë të përbashkët tatimore (shih Fig. 3).

Gjatë diferencimit të përgjigjeve në mes të partive të majta dhe sindikatave bie në sy që, këto të parat, parimisht përkrahin një tatim minimal, derisa këto të fundit anojnë më tepër drejt një baze më të fortë tatimore. Harmonizimi i bazës llogaritëse kuptohet jo rrallë si qëndrim pragmatik për një integrim të përgjithshëm, të cilës, gjatë zhvillimit të mëtejshëm, mund t'i bashkangjitet më vonë edhe



**Fig. 3: Tatimi minimal mbarëeuropian i ndërmarrjeve**  
(majtë-djathtë)



një shtrirje më e gjërë. Nga partitë konservative kjo është marrë poashtu si një argument kundër një baze të përbashkët tatimore. Një rregullim gjithpërfshirës mirret zakonisht si një alternativë për përcaktimin e një përqindjeje minimale tatimore. Socialdemokratët italian shkojnë aq larg, sa që parashohin që shtetet e reja anëtare, për një harmonizim të tatimeve, ti kompenzojnë financiarisht (p.sh. përmes fondeve strukturore). Nga partitë e majta dhe sindikatat në vendet e Europës Lindore favorizohet poashtu futja e koridoreve tatimore në mënyrë që të parandalohet një garë e ofertave të ulëta. E majta sllovaqe është më e rezervuar sa i përket futjes përbri të konkurrencës tatimore përmes një harmonizimi të bazës matëse, gjë që mund të arrihet përmes OMK-së. Në anën tjetër, ideja për një tatim të UE-së që mundet në mënyrë direkte të referohet në mes të UE-së dhe popullit votues, shihet nga partitë demokrate të majta në Europën Lindore so një alternativë e mundshme apo kompensim, deri sa kërkesa e sindikalistëve edhe në këtë rast përqëndrohet mbi një tatim minimal të ndërmarrjeve. Nga ana e partive konservative dhe liberale, si dhe nga shoqatat e punëdhënësëve refuzohet një tatim minimal, njëashtu edhe ideja për harmonizimin e bazës llogaritëse përkrahët vetëm sporadikisht.

Nëse shiqohen pozicionet e tatimeve minimale në bllokun e shteteve me mirëqenie të lartë, atëherë, në shumicën e grupeve të vendeve tregohet një qëndrim përkrahës. Më së shumti zëra kritik mund të dëgjohen parasëgjithash në Britani të Madhe, Irlandë si dhe vendet skandinave (shih Fig. 4)

## Zhvillimi rural në vend të politikës konvencionale agrare

Sa i përket status quo-së në politikën e përbashkët agrare, ekzistojnë në mesin e fuqive të majta europiane dy linja të vrazhda argumentative: Së pari, GAP-i në këtë formë konsiderohet të jetë i nevojshëm por relativisht joeficient. Prej kësaj rrjedhë një përkrahje për rishqyrtim të politikës agrare, e cila orientohet më tepër në një politik të hulumtimit dhe zhvillimit, mirëmbajtjes së ambienteve, përpunimit ekologjik të tokës dhe që kundërshton subvencionimin e çmimit.

Argumenti tjetër ka të bëjë me çështjen e drejtësisë dhe sinqeritetit, qoftë brenda një vendi qoftë sa i përket ndikimeve të GAP-it në tregun botëror. Nga kjo rrjedhë që, duke kaluar koha: shpenzimet zvoglohen, vendosën kufijtë e skajshëm të ndërmarrjeve dhe do të përkrahej zhvillimi rural. Argumenti i fundit theksohet më tepër nga ana e sindikatave. Për këtë sferë politike nuk shfaqet një mostër e qartë: as nuk ka një pozicion tejsht-

tetëror të majtë, e as blloqet e vendeve nuk janë në ujdi, me një dallim që, vendet e Europës Lindore, nuk dëshirojnë ti humbasin kërkesat e tyre të reja dhe për këtë arsye preferojnë një ulje të pagesave nga fondet strukturore për regjionet e përkrahura dhe të vjetra. Pasi që është rritur nevoja për mjete që nga zgjerimi në Lindje dhe që ka pak gjasa për ngritje të buxhetit(strukturor), kjo atyre ju duket zgjidhje praktike. Një qasje tjetër reformuese për GAP-in janë pagesat për zhvillimin e hapsirës rurale në vend të pagesave direkte.






Në njërën anë, në mesin e partive të majta dhe sindikatave europiane mibizotëron mendimi që regjionet e përkrahura të Europës Lindore duhet të marrin fonde strukturore, në të njejtën kohë nuk parashifet rritje e buxhetit të përgjithshëm, ku si pasoj regjionet e vjetra dhe të përkrahura do të duhej të hiqeshin nga programi. Ky mendim shprehet parasëgjithash nga ato vende të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me programin strukturor. Vetëm nga vendet e zgjedhura, si p.sh. Franca, Irlanda apo Danimarka mbahet pozicioni i tillë që mjetet për politikën strukturore dhe kohezive të rriten, në mes tjerash, përmes rritjes së kontributit të Britanisë së Madhe.

Socialdemokratët dhe sindikatat janë të një mendimi kur bëhet fjalë për parapëlqimin e qasjes së specifikuar sipas regjioneve, pasi që një gjë e tillë do t'i kontribuonte "depolitizimit". Posaqërisht nga vendet e Europës Lindore është ushtruar kritikë që, politika regjionale dhe strukturore qëndron mbi baza të një shtruarje formale të kërkesave, një sistemi jotransparent dhe të komplikuar si dhe ofron pak kohë për një vlerësim të thelluar. Nga perspektiva çeke, ngushticat financiare të fondeve strukturore, të shkaktuara nga zgjerimi në Lindje, do të mund të eliminoheshin në dem të GAP-it.

## Nuk ka liberalizim gjeneral për shërbimet publike

Sa i përket çështjes së alternativave për direktivën e shërbimeve, ka një pretendë të shquar nga grupimet e majta politike për një ballafaqim të veçantësuar me shërbimet publike. Këto nuk do të duhej t'i nënshtroheshin një liberalizimi të përgjithshëm në këtë fushë. Në mes tjerash, këtu hyjnë sfera e arsimit dhe furnizimit publik. Një listë e tillë negative do të duhej të ishte e unifikuar dhe nuk do të duhej të përcaktohej nga shtetet anëtare veç e veç.

Në shumicën e rasteve, koncepti alternativ mbi parimin e vendit mikëpritës, gjenë përkrahje tek partitë e majta. Mendimet rreth problematikës së parimit të prejardhjes së vendit, nuk pëlqehen apo pëlqehen në mënyrë të kufizuar nga partitë konservative, atyre liberale si dhe shoqatave të punëdhënësëve.



**Fig. 4: Tatimi minimal mbarëeuropian i ndërmarrjeve (sipas grupeve të vendeve)**



## Rezultatet

Mbi një bazë tejet të përgjithësuar (nevoja për paktin stabilizues dhe të zhvillimit, forcimi i dimensionit social, përkrahja për dialogun social, politika strukturore) u gjetë një pajtim në mes të partive dhe vendeve. Në një shkallë të vogël abstraksioni rriten dallimet ndërpartiake dhe në mes të vendeve. Sa i përket propozimeve për reforma, pajtueshmëri relativ homogjene brenda familjeve partiake mund të gjinden tek partitë konservative dhe liberale. Në këtë rast bëhet fjalë kryesisht për reformat, të cilat kërkojnë më shumë integritet në formë të një de-regullimi më të madhë. Kështu që refuzohen edhe propozimet rreth koordinimit më të fortë të politikave të punësimit dhe pagave, ashtu siç refuzohet edhe një pagë minimale e UE-së sipas specifikave të vendeve apo një vjelje e unifikuar e tatimit të ndërmarrjeve. Poashtu edhe masat anticiklike apo koncepti i koordinimit makroekonomik hasin në kundërshtim relativisht të unifikuar brenda partive konservative dhe liberale. Në të kundërtën, pajtueshmëria gjenerale për harmonizimin e tregut të shërbimeve është shumë e madhe te këto familje partiake. Qoftë sa i përket përkrahjes së vazhdueshme për "integrim negativ" përmes zgjerimit të tregut të brendshëm, ashtu edhe për refuzim të "integritetit pozitiv" përmes rregullimit më të fortë të tregut të UE-së, mbizotëron një përkrahje e gjërë në krahun e djathtë të spektrit partiak.

### Kalkulimi i shpërndarjes për klientelë vetanake ka përparësi

Vetëm në raste të ralla mund të vërehet një qëndrim i përbashkët në anën e majtë të spektrit partiak. Edhe pse perceptimi i problemit është shpesh identik, siç është rasti me garën për tatim apo ciklet e ndryshme konjukturale brenda UE-së. Ndërsa, te propozimet konkrete për reforma, shfaqen brenda të majtëve shpesh dallime të qarta në mes të grupeve të vendeve. Me këtë rast, poashtu njëzëshëm nuk refuzohen reformat e mëtutjeshme për "krijim të tregjeve". Kështu për shembull, disa parti të majta të Europës Lindore, e kanë përkrahur direktivën e shërbimeve në versionin e një bllok-njësie. Gjatë reformave për rregullim të tregut apo transferit të kompetencave në nivel të UE-së ekziston poashtu një pozicion i unisuar i partive të majta – të mesme, megjithëse ka raste kur këtu dalin në pah mostra refuzuese dhe miratuese,

mvarësisht prej vendeve. Socialdemokratët skandinav janë relativisht të vendosur për moskalim të kompetencave në nivel të UE-së, p.sh. sa i përket politikës së pagave dhe të punësimit apo në fushën e tatimit të ndërmarrjeve. Sidoqoftë, ato përkrahin përcaktimin e përqindjes minimale për tatimin e ndërmarrjeve apo harmonizimin e bazës matëse. Këtyre propozimeve iu rezistojnë parasëgjithash partitë e majta të Europës Lindore, megjithëse, transferimi i kompetencave shihet nga ato me më pak skepticizëm se që është rasti me të majtit skandinav (p.sh. masat ciklike, koordinimi më i fortë politikës së punësimit, kompetencat e Komisionit mbi tatimin). Nëse mirren parasysh konsekuencat e ndryshme shpërndarëse të rregullimeve të shtuara si dhe transferi i kompetencave, atëherë ky shqyrtim ndoshta mund të shpjegohet: Një kërkesë më e lartë për rregullim pa kompetenca direkte të UE-së do t'ja rriste harxhimet posaqërisht vendeve të Europës Lindore. Në anën tjetër, vendet skandinave do të afektoheshin shumë pak nga standardet e rregulluara minimale, ndërsa do të përfitonin në këtë mënyrë nga përparësitë rënëse konkurrese të vendeve më pak të rregulluara. Si pasojë, presioni garues dhe konkurrese, që shënon rënie në këtë mënyrë, i'a lehtëson partive të majta në këto vende t'i mbajnë apo t'i zvoglojnë masat për rishpërndarje. Një transferim i kompetencave, i cili do të ishte i nevojshëm gjatë procesimit të masave anticiklike, do të kishte efekt tjetër në shpërndarje. Pasi që në rastin e kompetencave direkte të UE-së, vendet e Europës Lindore do të ishin të afektuara relativisht pak nga harxhimet e pësuar nga financimi i pabarabartë i buxhetit të UE-së, ato do t'i gëzonin plotësisht ndikimet e rishpërndarjes në mes të vendeve të UE-së. Kështu që, krahasimisht, kalkulimi i harxhimeve të shpërndarjes do të ishte i volitshëm për vendet e Europës Lindore, ndërsa vendet skandinave do të ishin krahasimisht më shumë të përfshira në financim dhe do të përfitonin më pak nga rishpërndarja ndërshtetërore. Këto ndikime të ndryshme të shpërndarjes të transferit të kompetencave dhe rregullimeve sqarojnë poashtu pse vendet e Europës Jugore marrin në të dy rastet pozicione më të afërta për integrimin. Pasi që këtu mund të vërehet që qoftë shpenzimet dhe dobia nga transferi i kompetencave drejtpeshohen, qoftë që nuk do të thotë se rregullimet europiane nuk kërkojnë një përshtatje të standardeve të veta.

## Bibliografia

- Allsopp, Christopher / Artis, Michael (2003): The Assessment. EMU, Four Years on. nê: Oxford Review of Economic Policy 19(1), f. 1-29.
- Böhret, Carl / Grunow, Dieter / Ziekow, Jan (2005): Überprüfung ausgewählter Aspekte des Vorschlags zu einer Richtlinie des Europäischen Parlaments und des Rates über Dienstleistungen im Binnenmarkt KOM 2004 (2), Studie für das Land Nordrhein-Westfalen, Speyer/Duisburg.
- Boix, Carles (1998): Political Parties, Growth and Equality. Conservative and Social Democratic Economic Strategies in the World Economy, New York.
- Boldrin, Michele / Canova, Fabio (2003): Regional Policies and EU Enlargement. nê: Funck, B. / Pizzati, L. (Hg.), European Integration, Regional Policy, and Growth, Washington, S. 33-94.
- Budge, Ian / Keman, Hans (1990): Parties and Democracy. Coalition Formation and Government Functioning in Twenty States, Oxford.
- Buti, Marco / Eijffinger, Sylvester / Franco, Daniele (2003): Revisiting EMU's Stability Pact. A Pragmatic Way Forward. nê: Oxford Review of Economic Policy 19(1), f. 100-111.
- Buti, Marco / Nava, Mario (2003): Towards a European Budgetary System. Paper prepared for the Annual Congress of the IIPF, [http://www.iue.it/RSCAS/WP-Texts/03\\_08.pdf](http://www.iue.it/RSCAS/WP-Texts/03_08.pdf).
- Büttner, Thies (2006): Steuerwettbewerb und Finanzausgleich, ifo Schnelldienst 4/2006, f. 12-18.
- Cameron, David (1985): Does Government Cause Inflation? Taxes, Spending, and Deficits. nê: Lindberg, L. / Maier, C. (Hg.), The Politics of Inflation and Economic Stagnation. Theoretical Approaches and International Case Studies, Washington, f. 224-279.
- Esping-Andersen, Gøsta (Hg.) (1996): Welfare States in Transition, National Adaptations in Global Economies, London.
- Europäische Kommission (2004): Die Kohäsion am Wendepunkt 2007. Verordnungsvorschläge der Europäischen Kommission zur Reform der Kohäsionspolitik (Zeitraum 2007-2013), [http://www.europa.eu.int/comm/regional\\_policy/sources/docgener/informat/reg2007\\_de.pdf](http://www.europa.eu.int/comm/regional_policy/sources/docgener/informat/reg2007_de.pdf)
- Europäische Kommission (2005): Zusammenarbeit für Wachstum und Arbeitsplätze. Ein Neubeginn für die Strategie von Lissabon. KOM (2005) 24, [http://europa.eu.int/growthandjobs/pdf/COM2005\\_024\\_de.pdf](http://europa.eu.int/growthandjobs/pdf/COM2005_024_de.pdf).
- Europäisches Parlament (2005): Entwurf eines Berichts des Ausschusses für Binnenmarkt und Verbraucherschutz über den Vorschlag für eine Richtlinie des Europäischen Parlaments und des Rates über Dienstleistungen im Binnenmarkt, [http://www.dienstleistungsrichtlinie.dgb.de/dokumente/1\\_2\\_gehardtbericht\\_eil1u2.pdf](http://www.dienstleistungsrichtlinie.dgb.de/dokumente/1_2_gehardtbericht_eil1u2.pdf)/ fi-le\_view\_raw.
- Filc, Wolfgang (2005): Die Europäische Wirtschafts- und Währungsunion. Ein unvollendetes Kooperationsprojekt, WSI-Mitteilungen 12/2005.
- Ganghof, Steffen (2000): Adjusting National Tax Policy to Economic Internationalization Strategies and Outcomes. In: Scharpf, F. / Schmidt, V. (Hg.), Welfare and Work in the Open Economy (Vol. II). Diverse Responses to Common Challenges, New York, f. 597-645.
- Genschel, Philipp (2005): Globalization and the Transformation of the Tax State, nê: European Review 13(1), f. 53-71.



Hein, Eckhard / Niechoj, Torsten (2004): Leitlinien für ein dauerhaftes Wachstum in der EU? Konzept und Wirkung der Grundzüge der Wirtschaftspolitik, WSI-Diskussionspapier Nr. 126, Düsseldorf.

Hibbs, Douglas (1977): Political Parties and Macroeconomic Policy. nē: American Political Science Review 71, f. 1467-1487.

Hishow, Ognian (2005): Die Reform des Stabilitäts- und Wachstumspaktes, SWP-Aktuell 5, Stiftung Wissenschaft und Politik, Berlin.

Hix, Simon (1999): Dimensions and Alignments in European Union Politics. Cognitive Constraints and Partisan Responses. nē: European Journal of Political Research 35(1), f. 69-125.

Hooghe, Lisbet / Marks, Gary (1999): The Making of a Polity. The Struggle Over European Integration. nē: Kitschelt, H. et al. (Hg.), Continuity and Change in Contemporary Capitalism, Cambridge, f. 70-97.

Hooghe, Lisbet / Marks, Gary (2004): European Integration and Democratic Competition, Friedrich-Ebert-Stiftung, Europäische Politik, Bonn.

Hooghe, Lisbet / Marks, Gary / Wilson, Carole (2002): Does Left/Right Structure Party Positions European Integration? nē: Comparative Political Studies 35(8), f. 965-989.

Jarass, Lorenz / Obermair, Gustav (2005): Vorschlag für ein zukünftiges EU-Steuersystem, mimeo.

Keller, Berndt (2003): Sektorale Sozialdialoge. Vernachlässigte Bestandteile europäischer Arbeitsbeziehungen. nē: Industrielle Beziehungen 10(1): f. 9-40.

Lecher, Wolfgang / Platzer, Hans-Wolfgang (2003): Europäische Betriebsräte. nē: Schroeder, W. / Weßels, B. (Hg.), Die Gewerkschaften in Politik und Gesellschaft der Bundesrepublik Deutschland, Wiesbaden, S. 588-613.

Lommatzsch, Kirsten / Tober, Silke (2003): Reform der geldpolitischen Strategie der Europäischen Zentralbank, Wochenbericht des DIW 7/03, Deutsches Institut für Wirtschaftsforschung, Berlin.

Marks, Gary (2004): Introduction and Conclusion. nē: Marks, G. / Steenbergen, M. (Hg.), European Integration and Political Conflict, Cambridge.

Matuschek, Milosz (2005): Bolkestein-Richtlinie. Ein Anschlag auf das Europäische Sozialmodell? CAP-News vom 21.04.05, <http://www.cap-lmu.de/aktuell/positionen/2005/bolkestein.php>.

O'Connor, Julia (2005): Policy Coordination, Social Indicators and the Social Policy Agenda in the European Union. In: Journal of European Social Policy 15(4): f. 345-361.

Petring, Alexander / Kellermann, Christian (2005): New Options for a European Economic and Social Policy, Friedrich-Ebert-Stiftung, Europäische Politik, Bonn.

Sapir, André (Hg.) (2003): An Agenda for a Growing Europe. Making the EU Economic System Deliver. Report of an Independent High-Level Study Group Established on the Initiative of the President of the European Commission, Juli, Brüssel.

Scharpf, Fritz (1997): Economic Integration, Democracy and the Welfare State. nē: Journal of European Public Policy 4(1), f. 18-36.

Scharpf, Fritz (2002): The European Social Model. Coping with the Challenges of



Diversity. në: Journal of Common Market Studies 40(4), S. 645-670.

Schmidt, Manfred (1983): The Welfare State and the Economy in Periods of Economic Crisis. A Comparative Study of Twenty-Three OECD Nations. In: European Journal of Political Research 11(1), f. 1-26.

Schulten, Thorsten et al. (2005): Thesen für eine europäische Mindestlohnpolitik, [http://www.boeckler.de/pdf/wsi\\_2005\\_thesen\\_mindlohn\\_de.pdf](http://www.boeckler.de/pdf/wsi_2005_thesen_mindlohn_de.pdf).

Weale, Martin (2004): National Saving and the Stability and Growth Pact. në: Journal of Common Market Studies 42(5), S. 1033-1038.

Weise, Christian (2003): What Future for EU Regional Policy? në: Funck, B. / Pizzati, L. (Hg.), European Integration, Regional Policy, and Growth, Washington, f. 231-240.

Witte, Lothar (2004): Europäisches Sozialmodell und Sozialer Zusammenhalt. Welche Rolle spielt die EU?, Friedrich-Ebert-Stiftung, Europäische Politik, Bonn.



